



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BIBLIOTEKA
KOMBËTARE

**BIBLIOTEKA KOMBËTAR E
SHQIPËRISË**



FONDI
I ZHVILLIMIT TË DIASPORËS

**FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E
DIASPORËS**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

DHE

MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN

PREAMBUL

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Ministri i Shtetit për Diasporën (si konfirmues) të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë që ka bashkëpunimi me komunitetet shqiptare në diasporë në ndërtimin e urave lidhëse me vendlindjen;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në zhvillimin dhe promovimin e kulturës kombëtare në komunitetet shqiptare jashtë vendit, në funksion të interesit të ndërsjellë të palëve;

Duke vlerësuar rëndësinë e dhënies së informacionit bibliografik/albanologjik, si dhe qasjes në trashëgiminë e shkruar kulturore kombëtare të Diasporës shqiptare;

Me synimin për të përfaqësuar vlerat e kërkimit shkencor dhe bashkëveprimit dhe koordinimit të studimeve për kulturën dhe historinë për të promovuar dhe mundësuar qasje në trashëgiminë kulturore kombëtare për Diasporën shqiptare, si dhe çdo formë bashkëpunimi me interes të përbashkët;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet tyre, në vijim e quajtur Marrëveshje, për sa më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis palëve dhe realizimi i projekteve për mbështetjen dhe përhapjen e gjuhës/letërsinë shqipe dhe kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare jashtë vendit. Palët do të koordinojnë/bashkërendojnë veprimtarinë e tyre duke i dhënë rëndësi të veçantë kërkimit, hulumtimit dhe studimit të mundësive për ruajtjen, përhapjen dhe promovimin në Diasporën shqiptare të kulturës shqiptare në përgjithësi, si dhe gjuhës e letërsisë shqipe në veçanti.

Neni 2 Objekti i marrëveshjes

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Zhvillimin dhe promovimin e platformës “Digjitimi i Veprave Shqiptare”.
- b. Organizimin e veprimtarive të përbashkëta kulturore për gjuhën, letërsinë, kulturën dhe vlerat shqiptare në komunitetet shqiptare jashtë vendit (konferenca, seminare, ekspozita etj.), që synojnë vlerësimin e trashëgimisë kulturore të Diasporës shqiptare.

Neni 3 Baza ligjore

Marrëveshja do të respektojë legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji Nr. 8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin Nr. 9217, datë 8.4.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore.
- Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të".
- Ligji Nr.16, datë 05.04.2018, "Për Diasporën" dhe aktet nënligjore.
- Ligji Nr. 32, datë 07.06.2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës".
- Ligji Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (neni 119 dhe 121).

Neni 4 Detyrimet e palëve

Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje do të funksionojë si vijon:

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë do të realizojë:

4.1 Bashkëpunimin me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zhvillimin e platformës "Digjitimi i Veprave Shqiptare", për të mbështetur promovimin e veprave të letërsisë shqiptare në komunitetet shqiptare jashtë vendit.

4.2 Plotësimin e platformës "Digjitimi i Veprave Shqiptare" me vepra të autorëve shqiptarë të përjashtuara nga e drejta e autorit, - pjesë e fondit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, - në format elektronik, të cilat përfshihen në koleksionin e saj digjital: Biblioteka Digjitale e-Albanica.

4.3 Përcjelljen e veprave të autorëve shqiptarë në format elektronik (CD/DVD) nëpërmjet formës shkresore pranë Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

4.4. Bashkëpunimin me Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe/ose strukturat operative të caktuara prej tij për realizimin e veprimtarive kulturore, që synojnë promovimin e kulturës shqiptare, si dhe vlerave të trashëgimisë së shkruar kombëtare në komunitetet shqiptare jashtë vendit.

4.5. Organizimin me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës të veprimtarive të përbashkëta kulturore (konferenca, seminare, ekspozita etj.).

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të realizojë:

4.6 Bashkëpunimin me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë nëpërmjet strukturave operative të caktuara prej tyre për zhvillimin e platformës "Digjitimi i Veprave Shqiptare", e cila synon promovimin e veprave të letërsisë shqiptare dhe të huaj.

4.7 Përcjelljen pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në formë shkresore të listës së veprave të autorëve shqiptarë të përjashtuara nga e drejta e autorit, pjesë e Bibliotekës Digjitale e-Albanica, për t'i pasqyruar/përfshirë në platformën "Digjitimi i Veprave Shqiptare".

4.8 Vendosijen e logos së Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në platformën “Digjitimi i Veprave Shqiptare”.

4.9 Bashkëpunimin me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë për realizimin e veprimtarive specifike kulturore me fokus gjuhën e letërsinë shqipe (konferenca, seminare, ekspozita etj.), të cilat kanë për qëllim promovimin e gjuhës e kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare jashtë vendit.

Neni 5

Zbatimi dhe Komunikimi

5.1 Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vijueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose elektronike.

5.2 Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në këshillim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, në përfundim të çdo viti kalendarik.

5.3 Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e saj dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë një viti kalendarik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 6

Detyrime financiare

6.1 Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

6.2 Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk i imponon palëve detyrime financiare për të cilat ato nuk janë dakordësuar paraprakisht.

Neni 7

Kohëzgjatja dhe ndryshimi i marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ai mund të ndryshojë vetëm me dakordësimin paraprak të palëve nëpërmjet komunikimit me shkrim.

Neni 8

Zgjidhja e marrëveshjes

Marrëveshja zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Ajo nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen pranë Ministrit të Shtetit për Diasporën, 2 (dy) kopje pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe 2 (dy) kopje pranë Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Nënshkruar në Tiranë, më 04.09.2020

BIBLOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË

PIRO MISHA

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

MAJLINDA VOGLI

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO